

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. VALDETE HOXHA

07/01/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 29.6.2020 për subjektin e rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 1.7.2020, vendosi: Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Apelit, Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Lulzim Hamitaj, znj. Genta Tafa Bungo relatore, znj. Valbona Sanxhaktari anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.